

Vendim nr. 167 datë 17.07.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Fiona Papajorgji,	Kryesuese
Sandër Beci,	Anëtare
Illir Toska,	Anëtar

në datën 17.07.2024 mori në shqyrtim paraparak kërkesën nr. 10 (E) 2024 të Regjistrit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: ERMAL ALLA

OBJEKTI: Shfuqizimi i akteve të pushtetit publik të datave 25.01.2024, 29.01.2024, 05.02.2024 dhe 09.02.2024, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “f”, 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoji relatorin e çështjes Illir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Ermal Alla është i biri i shtetasit Lulzim Alla. Ky i fundit bashkë me vëllezërit e tij, sipas kërkuesit, kanë tjetërsuar tri parcela toke të llojit arë, të ndodhura në fshatin Mëzez, Tiranë, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. 1576 rep. dhe nr. 347 kol., datë 30.03.2001 (*akti*

noterial i shitjes), e cila është regjistruar në regjistrat e pasurive të paluajtshme dhe blerësi figuron si pronar i atyre pasurive.

2. Me pretendimin se akti noterial i shitjes është një akt i pushtetit publik i papajtueshëm me Kushtetutën, kërkuesi, në datën 15.08.2023, i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e këtij akti, me pretendimin se ai ishte lidhur pa miratimin e tij, duke i cenuar të drejtën e (bashkë)pronësisë. Me vendimin nr. 232, datë 08.11.2023, Kolegji i Gjykatës ka vendosur moskalimin e çështjes në seancë plenare, me arsyetimin se ankimi kushtetues individual i kërkuesit nuk plotësonte kriteret ligjore paraprake, ndërsa kërkuesi nuk kishte shteruar të gjitha mjetet juridike efektive në dispozicion, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës dhe nenit 31/a, pika 1, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577/2000, për sa kohë që pretendimet e tij mund t’i nënshtrohen procesit gjyqësor në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, mjet ky që nga pikëpamja e efektivitetit është në gjendje të riparojë të drejtën e pretenduar si të cenuar.

3. Në vijim, me pretendimin se regjistrimi i aktit noterial të shitjes është bërë në kundërshtim me ligjin, ndërsa ai si bashkëpronar i pasurisë së fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991 “Për tokën” nuk ka dhënë miratim për shitjen e saj, kërkuesi, në datën 20.01.2024, i është drejtuar me kërkesë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (*ASHK*), konkretisht Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2 (*DVTR 2*), duke i kërkuar anulimin e procedurës së regjistrimit të aktit noterial të shitjes dhe kthimin e pasurive të paluajtshme, të tjetërsuara nëpërmjet këtij akti noterial, në gjendjen e mëparshme. Në përgjigjen e datës 25.01.2024, *DVTR 2* i ka bërë të ditur kërkuesit se shërbimi i kërkuar nuk përputhej me atë sipas aplikimit *online*, ndaj duhej të kryente aplikimin përkatës, duke i bashkëlidhur dokumentacionin e domosdoshëm teknikoligjor.

4. Në datën 26.01.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish *ASHK*-së, duke i kërkuar informacion për aplikimin që duhej të bënte dhe për dokumentet që mungonin. Në përgjigjen e datës 29.01.2024, *DVTR 2* i ka bërë të ditur se për shërbimin që kërkonte duhej të ndiqte rrugën gjyqësore për shpalljen e pavlefshmërisë së aktit noterial të shitjes, çka ishte e domosdoshme sipas ligjit nr. 111/2018 “Për kadastrën”. Kërkuesi ka aplikuar përsëri në datën 30.01.2024, ku në përgjigjen e datës 05.02.2024, *DVTR 2* i ka bërë të ditur se nga verifikimi i bërë në arkivin e saj, nuk rezultonte të kishte aktin e marrjes së tokës në pronësi në emër të shtetasit Lulzim Alla, ndërsa pasuritë e tjetërsuara ky i fundit i ka përfituar si trashëgimtar i shtetasve Xh.A dhe L.A, të cilët kanë qenë të pajisur me aktet përkatëse të marrjes së tokës në pronësi. Në këtë rast, kërkuesit i

është kërkuar që nëse dispononte dokumentacion që vërtetonte se pasuritë e tjetërsuara nga shtetasi Lulzim Alla ishin përfituar me aktin e marrjes së tokës në pronësi, t'ia vinte në dispozicion ASHK-së. Në datën 09.02.2024 kërkuesi ka aplikuar sërish, duke pretenduar se përgjigja ishte e paqartë dhe jo shteruese. Po në këtë datë, DVTR 2 i ka bërë të ditur se ishte pajisur me informacion zyrtar për shërbimin e kërkuar.

5. Në datën 30.05.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me ankim kushtetues individual sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr.8577/2000, është regjistruar më 10.06.2024.

II

Pretendimet e kërkuetit

6. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar:

6.1 *E drejta e pronës private*, e garantuar nga neni 41 i Kushtetutës, pasi procesi administrativ i zhvilluar nga ASHK-ja për regjistrimin e aktit noterial të shitjes është bërë në kundërshtim me ligjin, për sa kohë kërkuesi është bashkëpronar i pasurisë dhe nuk ka dhënë miratimin për tjetërsimin e saj, sikundër është në kundërshtim me ligjin edhe refuzimi i organit publik për anulimin e këtij regjistrimi. Në këtë mënyrë e drejta e pronës private e kërkuetit është cenuar pa një proces të rregullt ligjor, në kundërshtim me nenin 42 të Kushtetutës.

6.2 *Parimi i mosdiskriminimit*, i parashikuar nga neni 18 i Kushtetutës, pasi nga veprimet dhe mosveprimet e organit publik, kërkuesi ndjehet i diskriminuar për shkak të gjendjes ekonomike ose sociale në raport me përfituesin nga akti noterial i shitjes, që është regjistruar në kundërshtim me ligjin, regjistrim të cilin ai ka kërkuar të anulohet.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuetit*

7. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik,

subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, shterimin e mjeteve juridike, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës. Kriteret për pranueshmërinë e ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative, në kuptimin që ato duhet të plotësohen njëkohësisht. Për pasojë, mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre që kërkuesi të mos legjitimohet për vënien në lëvizje të gjyimit kushtetues.

8. Një nga kriteret paraprake që duhet të plotësohet është dhe ai i *shterimit të mjeteve juridike efektive*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës. Sipas këtij kriteri, individi mund t’i drejtohet Gjykatës me ankim kushtetues individual vetëm pasi të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që ai pretendon se i janë cenuar. Mjetet ligjore konsiderohen të shteruara kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 35, datë 01.11.2021; nr. 38, datë 25.04.2017 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Sipas Gjykatës, si rregull, ligji zbatohet përmes akteve të organeve publike ose vendimeve gjyqësore, prandaj individi duhet, së pari, t’i kundërshtojë ato përpara gjykatave kompetente, duke shteruar të gjitha mjetet juridike që parashikon legjislativi i brendshëm. Kjo ka rëndësi edhe për të provuar se kërkuesi është prekur personalisht, drejtpërdrejt dhe realisht. Megjithatë, ligji ka parashikuar edhe rastet kur përmbushja e këtij kriteri është e pamundur (legjislativi nuk parashikon mjete juridike ose ato janë joefektive). Meqenëse mjete juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 04.10.2021 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkuesi ka ngritur pretendime në lidhje me procesin administrativ të zhvilluar nga ASHK-ja, për sa i përket ligjshmërisë së regjistrimit nga ajo të aktit noterial të shitjes dhe refuzimit për anulimin e këtij regjistrimi, përveçse edhe për sa i përket ligjshmërisë së aktit noterial të shitjes. Në ankimin e tij kushtetues, kërkuesi është shprehur se nuk ka qenë palë në ndonjë proces gjyqësor, pasi aktet që kundërshton (përgjigjet e DVTR 2)

nuk lënë mundësinë t'i drejtohet gjykatës, sepse ato, në thelb, përbëjnë refuzim për zbatimin e ligjit nga organi publik, çka i bën ato antikushtetuese.

11. Kolegji vëren se qëllimi i shterimit të mjeteve juridike, përpara së gjithash, vlen për t'iu ofruar mundësinë e korrigjimit të shkeljes, së pari, gjykatave të zakonshme. Ai bazohet në premisën se këto gjykata e kanë mundësinë e korrigjimit të saj dhe se kontrolli kushtetues ka natyrë subsidiare. Megjithatë, kjo nuk duhet të jetë vetëm një mundësi që i kërkohet individit të verifikohet formalisht, por duhet që, së pari, gjykatat e zakonshme të kenë kompetencën për të vendosur në lidhje me një çështje të caktuar, të shtruar përpara tyre për zgjidhje, në kuptimin që çështjet që më pas i nënshtrohen gjykimit kushtetues të jenë vlerësuar dhe t'u jetë dhënë një përgjigje përfundimtare nga ato gjykata në lidhje me bazueshmërinë e tyre.

12. Kolegji, fillimisht, konstaton se për pretendimet në lidhje me aktin noterial të shitjes, kërkuesi ka marrë përgjigje me vendimin nr. 232, datë 08.11.2023 të Kolegjit të Gjykatës, që ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare për shkak të mosplotësimit të kriterit paraprak të shterimit të mjeteve juridike efektive në dispozicion, ndërkohë që kërkuesi edhe pas kësaj nuk del të ketë ndërmarrë veprime për ngritjen e pretendimeve përpara gjykatave të juridiksionit të zakonshëm për të drejtën e pronësisë që pretendon se i është cenuar.

13. Në vijim, për sa u përket pretendimeve në lidhje me procesin administrativ të zhvilluar nga ASHK-ja, Kolegji konstaton se ligji nr. 111/2018 "Për kadastrën" ka njohur të drejtën e ankimit qoftë në rrugë administrative, qoftë në rrugë gjyqësore për këdo që pretendon cenimin e të drejtave ose interesave të ligjshëm nga aktet kadastrale ose mosveprimet e ASHK-së. Konkretisht, neni 65 i ligjit rregullon ankimet kundër ASHK-së, ku pika 1 e tij përcakton se, administrativisht, kundër akteve kadastrale ose mosveprimeve të ASHK-së paraqitet ankim te struktura përgjegjëse për ankimet, sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative (KPA). Ndërsa pika 2 e këtij neni përcakton se pas shqyrtimit të ankimit, sipas dispozitave të KPA-së, kërkuesit i lind e drejta e ankimit gjyqësor brenda 45 ditëve nga njoftimi i vendimmarrjes për ankimin ose nga data e mbarimit të afatit ligjor të shqyrtimit të ankimit, në rastin mosveprimit të ASHK-së.

14. Për sa më sipër, Kolegji vëren se për pretendimet në lidhje me aktet dhe mosveprimet e ASHK-së kërkuesi nuk ka përdorur mjetet ligjore administrative dhe ato gjyqësore në dispozicion dhe as ka arritur të argumentojë se përse paraqitja e ankimit kushtetues individual është mjeti i vetëm efektiv në dispozicion të tij për mbrojtjen e të drejtave kushtetuese që pretendon se i janë

cenuar. Për rrjedhojë, Kolegji çmon se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike efektive në dispozicion të tij përpara se t'i drejtohej Gjykatës.

15. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprahe për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronja “d”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.